



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E AKREDITIMIT E KOSOVËS



RAPORT VJETOR 2023



PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	3
1. ÇKA ËSHTË AKREDITIMI	4
2. HISTORIA E DREJTORISË	5
SË PËRGJITHSHME TË AKREDITIMIT TË KOSOVËS (DAK)	
3. SISTEMI I MENAXHIMIT TË CILËSISË	6
4. OBJEKTIVAT E CILËSISË	7
5. KOMPETENCA TEKNIKE	8
6. PAANSHMËRIA	9
7. FINANCIMI DHE DETYRIMI	10
8. BUXHETI I DAK-SË PËR VITIN 2023	11
9. VLERËSIMI PËR AKREDITIM I TRUPAVE	12
TË VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT	
9. TRUPAT E VLERËSIMIT TË	13
KONFORMITETIT TË AKREDITUAR	



SHKURTESAT

DAK - Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës

TVK - Trupi për Vlerësim të Konformitetit

KA - Këshilli i Akreditimit

KP - Këshilli Profesional

EA - European Co-operation for Accreditation (Bashkëpunimi Evropian i Akreditimit)

ILAC - International Laboratory Accreditation Cooperation (Korporata Ndërkombëtare për Akreditimin e Laboratorëve)

IAF - International Accreditation Forum (Forumi Ndërkombëtar i Akreditimit)

MAC - Multilateral Agreement Council (Këshilli për Marrëveshje Multilaterale)

MLA - Multilateral Agreement (Marrëveshje Multilaterale)

FMG - Free Movements of Goods (Lëvizja e Lirë e Mallrave) dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar)

QI - Quality Infrastructure (Infrastruktura e Cilësisë)

LT - Laborator Testues

LK - Laborator Kalibrues

LM - Laborator Mjekësor

TI - Trup Inspektues

ISO - International Organization for Standardization (Organizata Ndërkombëtare për Standarde)

IEC - International Electrotechnical Commission (Komisioni Ndërkombëtar për Elektroteknik)



1. ÇKA ËSHTË AKREDITIMI

Akreditimi përcakton kompetencën teknike, integritetin dhe paanshmërinë e organizatave që ofrojnë shërbime të vlerësimit të konformitetit si testimi, kalibrimi, certifikimi dhe inspektimi bazuar në standardet ndërkombëtare.

Akreditimi është një proces i paanshëm dhe objektiv që ofron rrugën më pak dyfishuese, më transparente dhe më të pranuar gjerësisht për ofrimin e rezultateve të besueshme të vlerësimit të konformitetit.



Akreditimi:

- Është demonstrimi zyrtar i kompetencës së Trupave të Vlerësimit të Konformitetit për të kryer detyra specifike të vlerësimit të konformitetit;
- Është vërtetimi i pavarur dhe autoritar i kompetencës, paanshmërisë dhe integritetit të Trupave të Vlerësimit të Konformitetit;
- Është “pasaporta” për tregtinë ndërkombëtare e bazuar në marrëveshje shumëpalëshe;
- Mbështet harmonizimin e procedurave të vlerësimit të konformitetit në nivel botëror;
- Është një kërkesë për të vepruar në fusha të rregulluara, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.



2. HISTORIA E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË AKREDITIMIT TË KOSOVËS (DAK)

Bazuar në Ligjin Nr. L/05-117, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës (DAK) është organi i vetëm shtetëror i Kosovës për akreditim të Trupave të Vlerësimit të Konformitetit. DAK është organ i pavarur i administratës shtetërore i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Organizimi dhe aktivitetet e DAK-ut rregullohen me Ligjin Nr. L/05-117 dhe në zbatim të kërkesave të Rregullores (KE) Nr. 765/2008 dhe standardit ISO/IEC 17011:2017.

Legjislacioni i mëposhtëm zbatohet për DAK:

- ❖ Rregullore (KE) Nr. 765/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 9 korrik 2008, për Përcaktimin e Kërkesave për Akreditim dhe Mbikëqyrjen e Tregut në Lidhje me Tregtimin e Produkteve dhe për Shfuqizimin e Rregullores (KEE) Nr. 339/93
- ❖ Ligji Nr. 05/L-117 për Akreditim
- ❖ Rregullore (MTI) Nr. 02/2018 e Këshillit Profesional
- ❖ Rregullore (MTI) Nr. 04/2017 për Këshillin e Akreditimit
- ❖ Udhëzim Administrativ (MTI) Nr. 04/2019 për Caktimin e Formës, Përmbajtjes dhe Përdorimit të Logos së DAK-ut dhe Simbolit të Akreditimit
- ❖ Udhëzim Administrativ (MTI) Nr. 01/2021 për Caktimin e Tarifave për Akreditim

Shërbimi i akreditimit në Republikën e Kosovës filloi në vitin 2006. Së pari u krye nga Njësia për Akreditim e Agjencisë së Standardizimit (AKS) bazuar në Ligjin Nr. 02/L-043 për Akreditim dhe Urdhrin Administrativ 2006/15 për organizimin dhe funksionimin e Njesisë së Akreditimit, datë 21.04.2006.

Njësia e Akreditimit u nda nga Agjencia e Standardizimit dhe u bë një organ i pavarur kombëtar i akreditimit, i quajtur: Drejtoria e Akreditimit e Kosovës (DAK), në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në Dhjetor 2008. Ajo u themelua me Ligjin Nr. 03/L-069 për Akreditim. Ligji Nr. 03/L-069 u ndryshua dhe plotësua më 28.06.2011 nga Ligji Nr. 04/L-007. Një ligj i ri për akreditim, Nr. 05/L-117, është publikuar më datë 12.01.2017 në përputhje me kërkesat e Rregullores (KE) Nr. 765/2008.



3. SISTEMI I MENAXHIMIT TË CILËSISË

Sistemi i menaxhimit të cilësisë i DAK-së është krijuar, dokumentuar, zbatuar dhe mirëmbajtur. DAK vazhdimisht përmirëson efektivitetin e sistemit të saj të menaxhimit. DAK kontrollon zbatimin e politikës së cilësisë dhe politikave të tjera përmes rezultateve të auditimeve të brendshme, kënaqësisë së klientëve dhe autoriteteve së bashku me statusin e efektivitetit të veprimeve korrigjuese, masave që rrjedhin nga rishikimet e menaxhimit, ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e menaxhimit të cilësisë, si dhe si rekomandime për përmirësim.



DAK është e vetëdijshme që vetëm stafi i trajnuar dhe kompetent, me përvojë praktike janë çelësi i një ecurie të përshtatshme dhe efektive të proceseve të akreditimit. Prandaj, DAK organizon trajnime të vazhdueshme për stafin e saj (të brendshëm dhe të jashtëm), si dhe monitoron efektivitetin e tyre.



4. OBJEKTIVAT E CILËSISË

- ❖ Rritja e kënaqësisë së autoriteteve dhe klientëve
- ❖ Ulja e numrit të ankesave dhe apeleve
- ❖ Ulja e nevojës për veprime korrigjuese

- ❖ Përfshirja e suksesshme e kryevlerësuesve dhe vlerësuesve teknikë në proceset e akreditimit
- ❖ Zhvillimi i skemave të reja të akreditimit
- ❖ Trajnimi i stafit të brendshëm dhe të jashtëm të DAK-së të përfshirë në proceset e akreditimit



- ❖ Vlerësimi i programeve të punës të realizuara dhe planeve financiare,
- ❖ Azhurnim i vazhdueshëm i sistemit të menaxhimit të DAK-së sipas standardeve përkatëse ndërkombëtare, rregullave dhe dokumenteve të organizatave evropiane dhe ndërkombëtare të akreditimit (EA dhe ILAC)
- ❖ Arritja e njohjes evropiane dhe ndërkombëtare (EA BLA, ILAC MRA).



5. KOMPETENCA TEKNIKE

DAK ka përcaktuar kërkesat lidhur me shkollimin, njohuritë, shkathtësitë dhe përvojën profesionale për të gjithë personelin me funksione të akreditimit.

Të gjithë personat që kryejnë funksione të akreditimit duhet:

- të kryejnë aktivitetet pa diskriminim, në mënyrë të paanshme, të lirë nga të gjitha ndikimet ekonomike dhe ndikimet tjera,
- të ruajnë konfidencialitetin e informatave të marra gjatë procesit, ku ato nuk mund t'u zbulohen palëve të treta, përveç nëse kjo parashihet në legjislacion dhe nëse Drejtori i Përgjithshëm i DAK jep leje të posaçme për këtë,
- të kryejnë detyrat siç dinë më së miri, me kompetencë përmbajtësore në fushën e tyre.



DAK i klasifikon kërkesat e kompetencës në tri grupe:

- Njohuritë: njohuritë (profesionale) të personit përkatës – në nivele të ndryshme,
- Shkathtësitë: shkathtësitë për zbatimin e njohurive të fituara; kompetenca bazike që sigurojnë përmbushjen e detyrave të dhëna fizike dhe intelektuale,
- Tiparet/veçoritë personale: kompetencat profesionale, të tilla si shkathtësitë menaxheriale dhe organizative, si dhe veçoritë psikologjike/fizike dhe përgjigjet ndaj situatave dhe informatave.



6. PAANSHMËRIA

Në fushën e akreditimit, rregulli i paanësisë kërkon që Trupi Kombëtar i Akreditimit (TKA) të jetë i paanshëm në marrjen e një vendimi për akreditimin. Kjo do të thotë që TKA nuk do të ketë ndonjë konflikt interesi me organin që aplikon për akreditim dhe se TKA nuk do t'i nënshtrohet asnjë presioni tjetër të natyrës tregtare ose financiare.

Kjo parashikohet në nenin 8 të Rregullores së Komisionit Evropian (EC) 765/2008 në lidhje me "Kërkesat për TKA-të", e cila thotë "që një TKA duhet të organizohet në atë mënyrë që ta bëjë atë të pavarur nga TVK-të që vlerëson dhe të presioneve komerciale dhe për të siguruar që të mos ketë konflikt interesi me TVK-të."



Kërkesat për paanshmëri

DAK zhvillon aktivitetet e saj të akreditimit në mënyrë të paanshme. Pavarësia, paanshmëria dhe integriteti i DAK-së tregohen me prova objektive në të gjitha nivelet (Këshilli Profesional, Këshilli i Akreditimit, Komitetet Teknike, stafi i DAK-së dhe të gjithë kryevlerësuesit, vlerësuesit teknikë dhe ekspertët teknikë) duke mos lejuar presione komerciale, financiare ose të tjera që komprometojnë paanshmërinë e tyre.

Personeli i DAK-së (i brendshëm dhe i jashtëm) dhe anëtarët e Këshillit Profesional, Këshillit të Akreditimit dhe Komiteteve Teknike, u kërkohet të veprojnë në mënyrë objektive dhe të jenë të lirë nga çdo presion i padrejtë tregtar, financiar dhe tjetër që mund të rrezikojnë paanshmërinë. Atyre u kërkohet të nënshkruajnë deklarata mbi paanshmërinë dhe konfidencialitetin dhe të deklarojnë, pa vonesë, për çdo konflikt të mundshëm interesi sa herë që mund të shfaqet.



7. FINANCIMI DHE DETYRIMI

DAK është një institucion jo-fitimprurës buxhetor. Detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet e saj mbulohen nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Sipas Ligjit Nr. 05/L-117 për Akreditim, burimet financiare për aktivitetet e DAK-së sigurohen nga Buxheti i Shtetit. Donacionet nga TVK-të nuk lejohen.



Tarifat për akreditim publikohen nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në Udhëzimin Administrativ (MTI) Nr. 01/2021. Të gjitha të ardhurat nga shërbimi i akreditimit dhe aktivitetet e tjera siç janë trajnimet i paguhen drejtpërdrejt Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT).



8. BUXHETI I DAK-SË PËR VITIN 2023

Gjatë vitit 2023 buxheti i DAK-së në total ka qenë 105,779.53, nga ato Mallra dhe Shërbime kanë qenë 39,592.00.



Sasia e burimeve financiare të nevojshme për funksionimin e DAK-së përcaktohet bazuar në aktivitetet e përcaktuara në Planin Vjetor të Punës. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë së bashku me Ministrinë e Financave i siguron DAK-së burimet e duhura financiare për:

- kryerjen e duhur të detyrave të saj,
- pagesën e tarifave të anëtarësimit në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të akreditimit,
- pjesëmarrjen në aktivitetet e organizatave evropiane dhe ndërkombëtare të akreditimit,
- pagesën e personelit të jashtëm të akreditimit (p.sh. anëtarët e Këshillit të Akreditimit, vlerësuesit dhe ekspertët).



9. VLERËSIMI PËR AKREDITIM I TRUPAVE TË VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT

Akreditimi i Trupave të Vlerësimin të Konformitetit (TVK) është vullnetar, që do të thotë se një TVK mund të zgjedhë të akreditohet në mënyrë që të mund të demonstrojë aftësitë e tij për të kryer vlerësime të besueshme në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Akreditimi bëhet i detyrueshëm vetëm nëse një ligj apo rregullore specifike e kërkon këtë, për shembull, për produktet që mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë e shëndetit të njerëzve, si: pajisjet e ndryshme, produktet, kimikatet, etj.

Bazuar në Ligjin e akreditimit 05/L-117, fushat e aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës janë si në vijim:

- Akreditimi i laboratorëve testues dhe kalibrues;
- Akreditimi i laboratorëve mjekësor;
- Akreditimi i trupave inspektues;
- Akreditimi i trupave për certifikimin e produkteve;
- Akreditimi i trupave certifikues të sistemeve të menaxhimit (cilësisë, ambientit etj.)
- Akreditimi i trupave certifikues të personelit; dhe
- Akreditimi i trupave tjerë për vlerësimin e konformitetit

SKEMAT E AKREDITIMIT TË DAK-SË

Aktualisht Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës ka të ngritura tre skema të akreditimit

Skemën e akreditimit të Laboratorëve Testues sipas kërkesave të standardit ISO/IEC17025:2017

Skemën e akreditimit të Trupave Inspektues sipas kërkesave të standardit ISO/IEC17020:2012

Skemën e akreditimit të Laboratorëve Mjekësor sipas kërkesave të standardit ISO 15189:2012



10. TRUPAT E VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT TË AKREDITUAR

Laboratorët testues

Emri	Fusha e Akreditimit
Byro projektuese STRUKTURA	Laboratori i materialeve ndërtimore
K.R.U HIDROREGJIONI JUGOR SH.A	Laboratorit i ujit
Dogana e Kosoves	Laboratori Doganore i naftës
Kosova-Lab	Laborator për cilësinë e derivateve të lëngëta të naftës
KRU "Gjakova" SHA	Laboratorit fiziko-kimik dhe bakterilogjik i ujit
Silca Group SH.A.	Laboratori i ujit "MIROS"
IPE PROING SH.P.K	laboratori i materialeve ndërtimore
SharrCem SH.P.K	Laboratori për testime kimike dhe fiziko mekanike të çimentos
N.Sh. "TEST&ING"	Laboratori i përzierjeve bituminoze dhe hulumtimeve gjeomekanike
"ACT-ing" SH.P.K	Laboratori i materialeve ndërtimore
N.SH"ETL-KOSOVA"	Laboratori për ekzaminimin e materialeve ndërtimore dhe shqyrtimin e konstruksioneve
AUV	Laboratori i Ushqimit dhe Veterinarisë
Sh.A."Birra Peja"	Laboratori Qendror i analizave kimike dhe mikrobiologjike të birrës, ujit dhe lëngjeve
INKOS	Laborator Testues i: Gjeomekanikës/ Lëndëve Djegëse /Matjeve elektrike/ Mjedisit/ Kontrollit pa shkatërrim / Defektoskopisë



Ex Fis LABS SH.P.K	Laboratori për analiza të derivateve të lëngëta të Naftës
"ADEA GROUP" Sh.p.k	Laboratori testues i Ujit
Stone Castle Vineyards L.L.C	Laboratori për testimin e parametrave fiziko-kimike të verërave dhe pijeve të forta alkoolike
N.P.N "AK-COMPANY" Sh.p.k	Laboratori i testimit të betonit produkteve të tij dhe përzierjes bituminoze
EUROLAB SH.P.K	Kontrollimi teknik i automjeteve
Ballkan Petrol SH.P.K	Laboratori për testimet fiziko-kimike të vajrave
RICENS SH.P.K	Laboratori i materialeve dhe strukturave ndërtimore
G&B "Tamponi"Sh.pk	Laboratori i materialeve ndërtimore
IKSHPK	Qendra e laboratorëve testues
N.SH "AGROVET"	Lab. testues i materialeve agrogjeologjike, agrogjeologjike, teknologjike, dhe ujë
Kolegji Europian	Laboratori elektrik dhe ambijental
KRU HIDROMORAVA	Laboratori i testimeve fiziko-kimike të ujit
NPT"FERPLAST"	Lab. për kontrollimin e masave plastike
"IMK Ballkan Projekt" Sh.P.K	Laboratori për shqyrtimin e materialeve ndërtimor, hulumtimeve gjeologjike dhe gjeomekanike, matjet elektrike, seizmike, ambienti dhe uji
„IPE CONTROLS-ING“ SH.P.K	Laboratori për analiza fiziko-mekanike të materialeve ndërtimore dhe strukturave të ndërtimit
IMN"Test-Beton" SH.P.K	Laboratori për ekzaminimin e materialeve ndërtimore
„IPE CONTROLS-ING“ SH.P.K	Laboratori për analiza fiziko-mekanike të materialeve ndërtimore dhe strukturave të ndërtimit
ALFA Eng Testing	laboratori i materialeve ndërtimore
KRU BIFURKACIONI	Laboratori i testimeve fiziko-kimike dhe mikrobiologjike të ujit
"M&Silloi" Sh.P.K	Laboratori i vetive kimike të grurit, miellit dhe himeve, M&S LABORATORY



Kolegji - UBT

Laboratorit i materialeve ndërtimore

Korporata Sara & Meti Sh.p.k

Laboratorit analitik, bujqësor dhe i ushqimit

Geokos A & A O.P

Laboratori për testimet gjeomekanike

IBMS

Laboratori i materialeve ndërtimore dhe strukturave

ACL Concrete Test

Laboratorit i materialeve ndërtimore

Laboratorët mjekësor

Emri

“OLIVE MEDICAL GROUP” SH.P.K.

Fusha e Akreditimit

Laboratori për Biokimi, Hematologji

Trupat inspektues

Emri

Euro-Inspekt N.SH.

Fusha e Akreditimit

Inspektimi i cilësisë së karburanteve të lëngëta të naftës dhe vajrave lubrifikuese si dhe verifikimi i mjeteve matëse të sasisë së lëngjeve të pikave shitëse të karburanteve të lëngëta të naftës dhe GLN-së dhe të autoboteve

GMC Kosova SH.P.K

Trup inspektues për sigurinë e ashensorëve, eskalatorëve dhe vinga

SIERRA-LAB SH.P.K

Inspektimi i cilësisë së karburanteve të lëngëta të naftës dhe vajrave lubrifikuese si dhe verifikimin e mjeteve matëse të sasisë së lëngjeve në pikat shitëse të karburanteve të lëngëta të naftës dhe autobote



Oliti SH.P.K.	Inspektimi i cilësisë së karburanteve të lëngëta të naftës
EUROLAB SH.P.K	Trup inspektimi për homologim të automjeteve
TAHOGRAPH SH.P.K	Trup Inspektues për inspektimin /verifikimin e tahografëve analog dhe taksimetrave
G.T.T. Service N.T.P	Trup Inspektues për inspektimin/verifikimin e tahografëve analog dhe taksimetrave
EJUP RAMADANI B.I. D.P.Z. KIENZLE	Trup Inspektues për inspektimin/verifikimin e tahografëve analog
Arben Xhigoli B.I. N.P. TAHO-TRIO	Trup Inspektues për inspektimin/verifikimin e tahografëve analog
D.P.Z. Autoelektricit-Tahografist Bosch	Trup Inspektues për inspektimin/verifikimin e tahografëve analog
Kontroll Test SH.P.K	Trup Inspektues për pajisjet nën presion me rrezikshmëri të lartë, me rrezikshmëri të ultë dhe valvolat e sigurorese
Arben Lushta B.I. D.P.T. Monark Auto Tacho	Trup Inspektues për inspektimin/verifikimin e tahografëve analog
Tacho ZMB SH.P.K	Trup Inspektues për inspektimin/verifikimin e tahografëve analog
Arbenita Duraku B.I. TACHO TECH	Trup Inspektues për inspektimin/verifikimin e tahografëve analog
NDT Kontrolli Sh.P.K	Trup Inspektues për pajisjet nën presion me rrezikshmëri të lartë, me rrezikshmëri të ultë dhe valvolat e sigurorese.
Green Tech Industry L.L.C	Trup Inspektues për inspektimin/verifikimin e tahografëve analog
"EALGA"SH.P.K.	Trup inspektues për sigurinë e ashensorëve, eskalatorëve dhe vinçave

